



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org

## **Dita botërore për siguri dhe shëndet në punë**

**Prishtinë 28 prill 2011-** Fondacioni Friedrich-Ebert-Stiftung - FES në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare për Mbrojtje në Punë – KOSHA, më 28 prill 2011, në Hotel Prishtina, organizuan Tryezë diskutimi për shënimin e Ditës botërore për siguri dhe shëndet në punë. Tema e shtruar në Tryezë kishte të bëjë me Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si mjet i përmirimit të vazhdueshëm.

Në këtë Tryezë, krahas përfaqësuesve të BSPK-së, ishin të ftuar edhe përfaqësues të Qeverisë, Inspektoratit të punës, si dhe përfaqësues të OEK-së, Shoqëritë Civile dhe ekspertë të lëmive të ndryshme. Tryeza kishte për qëllim të analizojë përparimet në sigurinë dhe shëndetin në punë në Kosovë, në kuadër të përpjekjeve globale, ashtu si rekomandon ILO-ja për Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë si mjet për përmirësim të vazhdueshëm.

Basri Ibrahim, kryeinspektor në Inspektoratin e Punës, tha që Inspektorati i punës nuk posedon informata të mjaftueshme rreth lëndimeve në vendet e punës si dhe nuk kanë sistem të grumbullit të informatave, nuk kanë numër të sakte të bizneseve dhe nuk disponojnë me instrumentet që masin rrezikshmërinë në vendin e punës. Po ashtu Ibrahim i potencoi se ka edhe mungesë të inspektorëve, sepse vetëm 50 inspektorë sa janë, nuk mjaftojnë për të mbuluar tërë territorin e Kosovës. Kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi i konsideron shqetësuese rastet e vdekjes dhe lëndimeve në vendin e punës për shkak të kushteve të këqija në vendin e punës. Deri vonë ka munguar edhe Ligji i punës, vazhdoi Arifi por edhe pse ekziston, Ligji për siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, i vitit 2003 duhet të zhvillohen më shumë aktivitete për implementimin e këtij ligji. Edhe pse me këtë numër të inspektorëve është vështirë që të behet një inspektim i mirëfilltë, implementimi i Ligji të Punës dhe Ligji për siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës do të ndikonte në zvogëlimin e rasteve të lëndimeve në vendin e punës. "Si sindikatë kemi obligim funksionalizimin e sektorit privat, ndërsa si armë me e forte e konsiderojmë bashkëpunimin e gjithë faktorëve relevant për implementimin e legjislacionit përkatës"-

potençoi Haxhi Arifi.

Pati edhe diskutime me kërkesë që të merren masa ndaj punëdhënësve, te cilët nuk e respektojnë Ligjin e Punës dhe Ligjin për siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si mënyre e vetme për zvogëlimin e rasteve të lëndimeve dhe vdekjes në vendin e punës. Në Tryeze u diskutua edhe për mungesën e të dhënave për rastet e lëndimeve dhe të vdekjeve në vendin e punës, me qëllim të analizës së tyre profesionale dhe shkencore, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe ambientit të punës dhe mbi këtë bazë edhe zvogëlimin e tyre. Në fund të këtij diskutimi, u shtrua si nevojë bashkëpunimi në nivel më të lartë në mes të faktorëve relevantë dhe ngritjen e vetëdijes së punëtorëve dhe të punëdhënësve për këtë çështje.

**Zyra për Informim, BSPK  
Fatma Rastelica**